

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci,	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 11.12.2000, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën me nr.88/1 Akti, që i përket:

KËRKUES: LULËZIM LAMA, përfaqësuar nga avokat Përparim Sanxhaku

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.240, datë 17.7.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.170, datë 26.10.1998 të Kolegjit të Gjykatës së Kasacionit

Në kërkesë si dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, përfaqësuesi i kërkuarit ka parashtruar si shkak:

- Ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, i cili ka deklaruar fajtor e dënua në mungesë me dy vjet heqje lirie, ka bërë ankim Prokurori i Rrethit të Krujës dhe Gjykata e apelit Tiranë e ka shqyrtuar çështjen në mungesë të kërkuarit dhe të avokatit, duke mos zbatuar kërkesat e nenit 426 paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë mënyrë, duke u zhvilluar një proces i parregullt, atij i është mohuar e drejta e mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi pretendimet e përfaqësuesit të kërkuarit dhe shqyrtoi çështjen,

V Ë R E N :

Gjykata e Rrethit të Krujës, ka gjykuar në mungesë kërkuarin Lulëzim Lama, i akuzuar për shkelje të rregullave të qarkullimit automobilistik me pasojë vdekje dhe në bazë të nenit 290 të Kodit Penal, me vendimin nr.37, datë 26.5.1998 e ka dënua me 2 (dy) vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokurori i Rrethit të Krujës dhe Gjykata e Apelit në Tiranë, me vendimin nr.240, datë 17.7.1998, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e dënua kërkuarin me 8 (tetë) vjet burgim. Gjykata e Kasacionit (Kolegji Penal) nuk ka pranuar për shqyrtim rekursin e paraqitur nga kërkuari, duke arsyetuar në vendimin nr.170, datë 26.10.1998, se rekursi nuk përmban shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin, se vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Kolegji Penal të Gjykatës së Kasacionit, janë rezultat i një procesi të parregullt në kuptimin kushtetues duke u cënua e drejta themelore e kërkuarit për mbrojtje.

Kërkuari Lulëzim Lama, është gjykuar në mungesë në gjykatën e faktit, duke iu caktuar kryesisht një mbrojtës. Nga Gjykata e Apelit, ku është shqyrtuar apeli i prokurorit që kërkonte ndryshimin e vendimit, duke caktuar një dënim më të rëndë, edhe pse kërkuari ishte përsëri në mungesë, nuk është marrë asnjë masë për të realizuar mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës. Gjykata e Apelit, në radhë të parë, nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 426/1 të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me njoftimet para fillimit të gjykimit. Nga ana tjetër, ajo s'ka marrë asnjë masë për t'i caktuar një mbrojtës kërkuarit që vazhonte të gjykohej në mungesë. Kjo do të garantonte një minimum të domosdoshëm të mbrojtjes të të drejtave të tij dhe do të siguronte një proces të rregullt ligjor. Aq më tepër që në rastin në fjalë, çështja në Gjykatën e Apelit, shqyrtohej mbi ankimin e prokurorit, i cili pretendonte, se kërkuarit i ishte dhënë një dënim i butë. Veç kësaj, kjo Gjykatë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë e ka bërë nëpërmjet shqyrtimit në themel, duke i rivlerësuar provat e administruara nga gjykata dhe duke arritur në konkluzione krejt të kundërta, pa u zbatuar parimi i kontradiktoritetit.

Megjithëse kjo shkelje është rilevuar, krahas problemeve të tjera, në rekursin paraqitur

Gjykatës së Kasacionit, Kolegji Penal, padrejtësisht nuk e kalon çështjen për shqyrtim dhe me vendimin nr.170, datë 26.10.1998 arsyeton, se nuk ka shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Në këtë mënyrë, Kolegji anashkalon faktin, se pikërisht mungesa e mbrojtjes, në rastin konkret, është shkelje e parimeve esenciale të procesit penal, gjë që e bën këtë proces të parregullt në kuptimin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 42 pika 2 e 131 shkronja “f” të Kushtetutës dhe 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.240, datë 17.7.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.170, datë 26.10.1998 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Kasacionit.

Dërgimin e çështjes Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 29.1.2001
Nr.88/1 i Regj. Themeltar
Nr. 3 i Vendimit